

L I G J
Nr.8188, datë 23.1.1997

PËR NDALIMIN E SKEMAVE PIRAMIDALE MASHTRUESE TË HUAMARRJES

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Huamarrja e organizuar në bazë të skemave piramidale mashtruese është veprimtari e paligjshme.

Neni 2

Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes përbën krim dhe dënohet me jo më pak se 20 vjet burgim dhe me konfiskim të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme.

Neni 3

Personat që punojnë a ndihmojnë për realizimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes, kur për shkak të punës që kryejnë kanë dijeni për këtë veprimtari, dënohen me jo më pak se 10 vjet burgim dhe me konfiskim të përfitimeve ose të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të vënë prej saj.

Neni 4

Organet e prokurorisë, kur fillojnë çështjen penale, kryesisht ose në bazë denoncimi, ndaj personave për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se janë autorë të veprave penale të përmendura në nenet 2 ose 3 të këtij ligji, vendosin sekuestrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, me qëllim mbrojtjen e interesave pasurore të personave të dëmtuar dhe sigurimin e zbatimit të vendimit penal.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi më datën 23.1.1997.

Shpallur me dekretin nr.1708, datë 23.1.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha